



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**KRYETARI I KOMUNËS**

**01. nr. 031 - 49267, më 22.02.2016**

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më 22.2.2016, merr këtë

**V E N D I M**

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e Grupit punues për projektin "SoRI", në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe organizatës "Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit" (GIZ) GmbH.
- II. Grupi punues i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
  1. Premtime Preniqi, koordinatorë, Njësia komunale për të drejtat e njeriut;
  2. Lulzim Vrapca, Zyra për komunitete dhe kthim;
  3. Hyzri Bunjaku, Drejtoria e Arsimit;
  4. Vehbi Mujku, Qendra për Punë Sociale;
  5. Lindita Hajdari, Drejtoria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit;
  6. Leonora Spahiu, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
  7. Arbër Kadriu - INPO.
- III. Detyrat e Grupit punues janë:

- a) Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të të gjithë akterëve për identifikimin, arritjen dhe qasjen tek grupet më të prekura të popullsisë në komunat përkatëse;
- b) Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të të gjithë akterëve për të drejtat e njeriut, respektivisht të drejtat sociale;
- c) Asistimi në formimin dhe funksionimin e grupit punues ndërsektorial, në nivel komune (sipas termave të referencës që do të përcaktohen për këtë grup);
- d) Asistim në ofrim cilësor të të gjitha shërbimeve për grupet më të prekura (fushat dhe temat e trajnimit do të identifikohen bashkërisht ndërmjet GIZ-it dhe Komunës);
- e) Ngritje të kapaciteteve për identifikimin, aplikimin dhe implementimin në fondeve të ndryshme, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në nivel komunal;
- f) Asistencë në rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me OJQ të ndryshme vendore dhe rajonale;
- g) Përkrahje për shërbimet në terren dhe aktivitetet vetëdijesuese (duke përfshirë këtu edhe shpërndarjen e informatave dhe kampanjat vetëdijesuese);
- h) Asistencë në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në kuadër të arritjes dhe qasjes në grupet e prekura, por edhe ofrimin e shërbimeve, sipas nevojës, për këto grupe;
- i) Monitorimi i aktiviteteve të parapara, ndryshimi apo përshtatja sipas kërkesave në terren.

IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, Grupi punues i raporton Kryetarit të Komunës.

V. Në takimin e parë koordinues, Grupi punues zgjedh kryesuesin e grupit, i cili do të kujdeset për koordinimin e aktiviteteve të grupit.

VI. Mandati i Grupit punues është 20 muaj, me mundësi vazhdimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**U dorëzohet:**

- Anëtarëve të Grupit punues;
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

